

2012/03

Politikbërja e Limituar e të Bërit Biznes

Analizë e politikave publike për avancimin
e ndërmarrësisë në Kosovë përmes përmirësimit
të indikatorëve të Raportit të të Bërit Biznes
të Bankës Botërore



Autorë: **Dita Dobranja dhe Darsei Canhasi me kontribut të Barbora Bodnarova**

Redaktor: **Krenar Gashi**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

658(496.51) 339.54

Politikbërja e limituar e të bërit biznes / përgatitur nga
Dita Dobranja, Darsei Canhasi. – Prishtinë INDEP,
2014. – 33 f. : ilustr. ; 28 cm.

1. Dobranja, Dita 2. Canhasi, Darsei

ISBN 978-9951-627-08-5



Bashkëpunimi Rajonal
Regional Cooperation



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development



Qeverisja Demokratike
Democratic Governance

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	3
2. Analiza e Raportit të të Bërit Biznes	4
2.1. Kosova dhe Raporti i të Bërit Biznes.....	7
2.2. Ndikimi i raportit të të bërit biznes	8
3. Analizë e Veprimeve të Qeverisë së Kosovës	9
3.1. Plani i veprimit për përmirësim të treguesve TBB	11
4. Ndikimi i TBB në Investime – Praktika nga vendet tjera	12
4.1. Gjeorgjia.....	12
4.2. Maqedonia	13
5. Indikatorët tjerë për të konsideruar.....	14
5.1. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit	15
5.2. Raporti Global i Konkurrencës.....	15
5.3. Indeksi i Lirisë Ekonomike	16
5.4. Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann.....	17
5.5. Perceptimi i Kosovës dhe sfera ndërkombëtare	17
6. Përfundime.....	18

1. HYRJE

Raporti i Të Bërit Biznes (TBB) është studim i Bankës Botërore që e bën njehsimin e indikatorëve kyç të të bërit biznes të një vendi. Raporti TBB shërben si një instrument monitorues i progresit dhe regresit vjetor të 185 shteteve të përfshira në raport. I publikuar që nga viti 2003, ky raport e bën vlerësimin e faktorëve mikroekonomik që ndikojnë në mjedisin e të bërit biznes në shtetet e botës. Ambienti i të bërit biznes është një nga treguesit e gjendjes ekonomike të një vendi. Procedurat e hapjes së një biznesi, regjistrimi i pronësisë, marrja e lejes së ndërtimit, zbatimi i kontratave e mbrojtja e investitorëve janë disa nga aspektet që e përcaktojnë cilësinë e ambientit e të bërit biznes. TBB paraqet një mundësi të vlefshme për çdo vend për të identifikuar trendin e lëvizjes në treguesit e ndryshëm që përfshihen në raport.

Origjina e Raportit TBB vjen nga një publikim mbi rregullat dhe procedurat në fushën e hapjes së një biznesi e që nga raporti i parë metodologjia dhe indikatorët pësojnë ndryshime nga viti në vit. Faktorët kryesorë që vlerësohen nga TBB për secilin indikator janë numri i procedurave të nevojshme, koha, kosto dhe mbrojtja ligjore. Kjo do të thotë që Raporti i të Bërit Biznes bazohet në aspektin rregullativ dhe përmirësimet në renditje bëhen nga reformat në kornizën ligjore të një vendi.

Për Kosovën, Banka Botërore publikoi TBB raportin e parë në vitin 2011, ku Kosova u rendit në vendin e 117-të në botë. Kjo renditje ishte e njëjtë edhe për raportin e vitit 2012, përderisa mesatarja e shteteve të rajonit është vendi i 77-të.¹ Renditja e tillë është cilësuar si alarmuese për Qeverinë e Kosovës dhe si rezultat përmirësimi i vendit në raportin e TBB është caktuar si një ndër objektivat ekonomike të vendit. Në Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës për vitet 2011-2014, i njohur edhe si Plani i Banskos, parashihet që me reformat e ndërmarra Kosova të renditen në top 40 shtetet reformuese në Raportin e të Bërit Biznes deri në vitin 2014 edhe pse një kategori e tillë ekziston në raport.² Ky plan i veprimit, i cili parasheh aktivitetet për zhvillimin ekonomik të Kosovës deri në vitin 2014, në masë të madhe cilëson përmirësimin në treguesit e raportit TBB si indikatorë të suksesit për aktivitetet e parapara.

Një ndër karakteristikat e raportit TBB është nxitja e reformave rregullative në ekonominë botërore që janë në zhvillim. Vetë Banka Botërore e cilëson këtë raport si shtysë të nevojshme për fillimin e reformave në sferën e të bërit biznes. Historikisht, shtetet në zhvillim kanë fokusuar politikave të tyre në përmirësimin e tregueseve të këtij raporti. Gjeorgjia dhe Maqedonia janë dy shtetet të cilat merren si shembuj për përmirësimin e renditjes në raportin e TBB brenda një kohe të shkurtër. Këto dy shtete i kanë dhënë prioritet politikave të ndërlidhura me raportin TBB gjë që ka rezultuar në renditjen e tyre në top 10, respektivisht top 30 shteteve në botë në këtë raport. Sidoqoftë, përmirësimi i renditjes në TBB nuk ka pasur rezultate pozitive në zhvillim këtyre vendeve. Implementimi i politikave me fokus jo vetëm të kufizuar por edhe të varur nga një raport si ky i TBB ka rezultuar në mungesë të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik dhe tërheqjes efektive të investimeve të huaja.

¹ Profili Ekonomik: Kosova, Raporti i të Bërit Biznes 2012, Banka Botërore. Tetor 2011

² Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014, Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Korrik 2011

Ky punim synon të analizojë rëndësinë dhe ndikimin e Raportit të Bërit Biznes në politikat e Qeverisë së Kosovës drejt përmirësimit të ambientit biznesor. Për më tepër, studimi i përfshinë edhe përvojat e qasjen e shteteve tjera që e bazuan politikbërjen e tyre në TBB. Përmes këtij punimi, INDEP po ashtu tenton të prezantoj një pasqyrë më të qartë të fushave të tjera ekonomike që duhen marrë parasysh në përpilimin e politikave për zhvillim ekonomik. Për më tepër, në këtë analizë konsiderohen raportet tjera me interes në zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investitorëve. Pasi që Kosova po e përdor TBB si një njehsues rreth suksesit në përmirësimin e gjendjes së të bërit biznes analiza gjithashtu është fokusuar në suksesin e TBB si një vlerësimi i ambientit të ndërmarrësisë së një shteti.

Duke përdorur metoda hulumtuese kualitative dhe analiza të të dhënave, ky punim do të qartësojë fokusin e ngushtë të raportit TBB. Prizmi i limituar i TBB, rrjedhimisht rezulton në politika më me synim të shkurtër që kanë për qëllim përmirësimin e renditjes në këtë raport e jo zhvillimin ekonomik.

Për këtë punim INDEP ka analizuar raportet e TBB në detaje duke u fokusuar në secilin nga indikatorët dhe procedurat që janë të përfshira në matjen e progresit në këto indikatorë. Fokus i veçantë u është kushtuar indikatorëve të cilët edhe vet qeveria e Kosovës i ka vënë si prioritet për përmirësim. Në anën tjetër, INDEP ka llogaritur korrelacionin në mes të renditjes në raportin e TBB dhe Investimeve të Huaja Direkte (IHD) për të analizuar ndikimin e renditjes në këtë raport në tërheqjen e investimeve. INDEP gjithashtu ka përdorur dhe analizuar katër raportet tjera kryesore në përcaktimin e gjendjes ekonomike në një shtet.³ Analiza e këtyre raporteve shërben për të identifikuar çështjet e rëndësishme ekonomike që duhen adresuar për të përmirësuar fillimisht stabilitetin ekonomik në Kosovës e më tutje edhe imazhin e përgjithshëm të ekonomisë Kosovare.

Fokusi i kufizuar i politikave ekonomike të një shteti në përmirësimin e suksesin në indikatorët e një raporti, që edhe vetë është i mangët, rezulton në mungesë të zhvillimit të mirëfilltë ekonomik. Hartimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore ka nevojë për përfshirje të një numri më të madh të faktorëve që ndikojnë në zhvillim dhe qëndrueshmëri ekonomike të një vendi. Politikat zhvillimore të një vendi duhet të jenë të bazuara në zhvillim dhe qëndrueshmëri ekonomike sipas analizave shkencore e jo për të konkurruar për një rankim apo tjetrin.

2. ANALIZA E RAPORTIT TË TË BËRIT BIZNES

Raporti i të Bërit Biznes ka për qëllim matjen e rregullave të të bërit biznes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në një shtet, duke i bërë matjet në qytetin më të madh biznesor. Ky raport bazohet në dhjetë indikatorë. Kategoritë në të cilat bizneset hasin në numrin më të madh të barrierave janë pagesa e taksave dhe sigurimi i energjisë elektrike.⁴ Performanca e shteteve në dhjetë indikatorët e raportit TBB e vendos renditjen e tyre. Pas matjeve, secili nga indikatorët shndërrohet në një rezultat numerik që e bënë të lehtë formimin e një rezultatit të përgjithshëm

³ Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Raporti Global i Konkurrencës, Indeksi i Lirisë Ekonomike dhe Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann

⁴ Rreth të Bërit Biznes: Matja e ndikimit, Banka Botërore, 2012

për një shtet të caktuar. Kësisoj, krahasimi i shteteve dhe i indikatorëve të ndryshëm ndërmjet tyre është i thjeshtë. Dhjetë indikatorët e TBB, që janë përdorur edhe për Kosovën, janë⁵:

1. Fillimi i biznesit
2. Marrja e lejes për ndërtim
3. Sigurimi i energjisë elektrike
4. Regjistrimi i pronësisë
5. Marrja e kredive
6. Mbrojtja e investitorëve
7. Pagesa e taksave
8. Tregtia përmes kufijve
9. Zbatimi i kontratave
10. Zgjidhja e pamundësisë së borxhit

Banka Botërore i përmend një mori limitimesh kryesore të TBB. Duke theksuar që TBB e ka një sferë të limituar të shtrirjes, ndër të tjerash përmendet që nuk e vlerëson sigurinë, mungesën e korrupsionit, stabilitetin makroekonomik e financiar, cilësinë e fuqisë punëtore, etj. Gjithashtu, TBB nuk i përmbledh të gjitha aspektet e kualitetit të infrastrukturës dhe nuk fokusohet në kornizën e përshtatshme rregullative rreth investimeve të huaja. Në anën tjetër, raporti gjithashtu fokusohet tërësisht në ekonominë formale dhe i analizon indikatorët për një lloji të caktuar të bizneseve që zakonisht janë ndërmarrje të vogla ose të mesme dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara.⁶ Të gjitha këto vetëkritika të TBB e ulin në masë të madhe besueshmërinë e raportit dhe e pamundësojnë pasqyrimin e gjendjes së reale të situatës.

Për të plotësuar të dhënat dhe përpiluar raportin për një shtet, Banka Botërore bashkëpunon me juristë, kontabilistë, persona të biznesit si dhe zyrtarë publik. Në vitin 2013, për 185 shtete të përfshira në raport, kanë qenë gjithsej 9,600 kontribuues.⁷ Për Kosovën, në vitin 2013, ka gjithsej 101 kontribuues që është një rritje substanciale në krahasim me vitin e kaluar përderisa mesatarja e kontribuuesve për një shtet është 52.⁸ Kontribuuesit janë persona fizik apo juridik që në shtete paraqiten në mënyrë vullnetare për të kontribuar në mbledhjen e të dhënave për shtetin ku ata veprojnë. Ata duhet t'i përkasin njërit nga profilet në vijim: avokatë, noterë, gjykatës, arkitektë, specialistë të logjistikës tregtare apo kontabilistë.

Kontribuuesit në nivel botëror dhe rajonal janë kompani të cilat kanë plotësuar anketa në zyrat e tyre nëpër botë. Numri i kontribuuesve që operojnë në qytete të tjera të Kosovës, përveç Prishtinës, është minimal fakt që e limiton aspektin gjithëpërfshirëses të TBB më tutje. Në metodologjinë e Raportit të Bërit Biznes, çdo indikator i përfshinë disa elemente specifike që maten e që janë të standardizuara. Standardizimi i metodologjisë garanton kompaktësi ndër vite dhe ndër shtete. Me ndihmën e këshilltarëve akademik, ekipi i TBB e përgatitë pyetësorin i cili më pas i shpërndahet kontribuuesve lokal. Zakonisht gjatë muajit tetor publikohet Raporti i të Bërit Biznes përderisa të dhënat merren deri më 1 qershor të po atij viti.

⁵ Ibid

⁶ Shënime për të Dhënat, Raporti i të Bërit Biznes 2013, Banka Botërore. 2012.

⁷ Ibid

⁸ Kontribuuesit në Kosovë, Raporti i të Bërit Biznes. 2012.

Për të ilustruar më mirë metodologjinë do të zbërthejmë masat të cilat ndikojnë në matjet e indikatorëve. Fillimi i biznesit ndahet në katër njësi matëse: numrin e ditëve për hapjen e biznesit, koston e lidhur me regjistrimin e biznesit, kapitalin paraprak dhe numrin e procedurave të nevojshme. Të katër elementet kanë rëndësi të njëjtë, gjegjësisht nga 25%.⁹ Këto njësi matëse vlejné edhe për indikatorët si leja për ndërtim, sigurimi i energjisë elektrike dhe regjistrimi i pronësisë.

Indikatori që mat marrjen e kredive bazohet në indeksin e të drejtave ligjore, indeksin e informatave mbi kreditë, mbulimin e regjistrimit publik dhe mbulimin privat. Indikatori mbi mbrojtjen e investitorëve bazohet kryesisht në mbrojtjen e investitorëve ndaj konflikteve të interesit, lehtësinë e marrjes së masave ligjore si dhe në indeksin e mbrojtjes së investitorëve në përgjithësi. Pagesat e taksave bazohen në dy matës të thjeshtë: numrin e pagesave që duhen bërë gjatë një viti dhe kohën e cila shpenzohet për t'i bërë këto pagesa. Indikatori i cili matë tregtinë jashtë kufijve fokusohet në numrin e dokumenteve të nevojshme, kohën dhe koston si për eksporte ashtu edhe për importe. Matja e nivelit të zbatimit të kontratave bëhet duke matur kohë, koston dhe numrin e procedurave të nevojshme. Zgjedhja e pamundësisë së borxhit matet bazuar në kohën, koston, rezultatin dhe shkallën e rimëkëmbjes.

Siç shpjegohet më vonë, MTI ka marrë një mori masash për të përmirësuar gjendjen për hapjen e një biznesi në Kosovë në raportin e ri duke synuar arritjen e ndryshimeve në katër elementet e përshkruara më lartë. MTI ka planifikuar që të rrisë renditjen duke bërë adaptimin e kornizës ligjore që vlerësohet nga Banka Botërore. Sidoqoftë, Kosova vazhdon të ketë probleme të mëdha në zbatimin e ligjit e jo në përpilimin e ligjeve të përshtatshme.

Marrja e kredisë është indikatori ku Kosova është e vlerësuar me notën më të mirë. Për vitin 2012 ishte e radhitur në vendin e 24, kurse në 2013 ishte në vendin e 23.¹⁰ Konkurrenca ndërmjet bankave komerciale e ka përmirësuar dukshëm efikasitetin e tyre që figuron në Raportin e të Bërit Biznesit. Sikurse indikatori i fillimit të biznesit, marrja e kredisë zbërthehet në katër nënkategori ku kryesisht matet burokracia dhe fuqia ligjore.¹¹ Përveç kësaj, nuk ka diçka më thelbësore që ky indikator përshkruan. Raporti i të Bërit Biznes dështon të konsiderojë kamatat e larta të bankave që në Kosovë janë tejet më të pavolitshme se të vendeve në rajon.

Sigurimi i energjisë elektrike është një fushë që i është shtuar TBB viteve të fundit. Kosova renditet në vendin e 116, që është renditje më e mirë se sa shumica e vendeve të rajonit.¹² Me sigurimin e energjisë elektrike, Banka Botërore e bën vlerësimin e procedurave për t'u pajisur me energji elektrike, kohën e nevojshme dhe koston.¹³ Ndërkohë, Kosova ka probleme të mëdha me mungesën e energjisë elektrike, ku vetëm 63% të energjisë që del nga rrjeti transmetues dedikohet për konsum për shkak të humbjeve marramendëse.¹⁴ Përderisa politikat e qeverisë kundrejt këtij problemi kanë qenë minimale, investitorët e jashtëm më shumë e shikojnë pasqyrën ekonomike të një vendi sesa Raportin e të Bërit Biznes.¹⁵ Realiteti ekonomik i zhvillimit të biznesit ndryshon

⁹ Metodologjia e Fillimit të Biznesit, Raporti i të Bërit Biznes, Banka Botërore. 2012.

¹⁰ Profili Ekonomik: Kosova, Raporti i të Bërit Biznes 2013, Banka Botërore. Tetor 2012.

¹¹ Metodologjia e Marrjes së Kreditit, Raporti i të Bërit Biznes, Banka Botërore. 2012.

¹² Profili Ekonomik: Kosova, Raporti i të Bërit Biznes 2013, Banka Botërore. Tetor 2012.

¹³ Metodologjia e Marrjes së Kreditit, Raporti i të Bërit Biznes, Banka Botërore. 2012.

¹⁴ Tregu i Energjisë Elektrike të Kosovës, Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu SH.A (KOSST).

¹⁵ Intervistë e INDEP me Ray Power, kryetar i Odës Ekonomikë Britanike në Kosovë. Prishtinë, Kosovë, Tetor 2012.

nga TBB, i cili është më i fokusuar në masat që duhen marrë për fillimin e një biznesi se sa për zhvillimin e veprimtarisë biznesore në afat të gjatë.

Raporti i të Bërit Biznes ka pësuar ndryshime substanciale ndër vite si në metodologji ashtu edhe në inkuadrimin e indikatorëve të rinj. Që nga raporti i parë i vitit 2003, çdo vit është karakterizuar me ndryshime të dukshme. Në vitin e fundit është bërë ndryshim i metodologjisë për tre indikatorë: marrja e kredisë, lejes për ndërtim dhe pagesa e taksave.¹⁶ Prandaj, politikbërja e Kosovës bazohet në një raport të ri i cili ende është në një fazë të ndryshimeve.

Duke e pranuar dobësinë e raportit për fokusin vetëm në qytetin më të madh të vendit, Banka Botërore ka filluar që të publikojë raporte rajonale ku përfshihen të dhëna për më shumë se një qytet. Kësisoj, është publikuar një raport për Evropën Jug Lindore në vitin 2011, ku për Kosovën është bërë matja vetëm në Prishtinë dhe Prizren përderisa në shumicën e shteteve tjera kemi më shumë se dy qytete të përdorura.¹⁷ Kjo formë e re e TBB vjen si rezultat i kritikave nga ekspertë të ndryshëm për anashkalimin e qyteteve dhe rajoneve tjera përveç kryeqytetit. Megjithatë, kjo përpjekje shumë pak kontribuon në përmirësimin e gjendjes për shkak se është pothuajse e pamundur të përfshihen të gjithë vendbanimet në një raport të vetëm.

2.1. KOSOVA DHE RAPORTI I TË BËRIT BIZNES

Nëse e analizojmë performancën e Kosovës në dhjetë indikatorët e TBB, shohim që marrja e kredisë është indikator i ku Kosova renditet më së miri kurse marrja e lejes për ndërtim më e dobëta. Më poshtë mund të gjeni performancën e Kosovës në TBB për vitin 2012 dhe 2013.¹⁸

Indikatori	Renditja në 2013	Renditja në 2012
Fillimi i Biznesit	126	170
Marrja e Lejes për Ndërtim	144	177
Sigurimi i Energjisë Elektrike	116	122
Regjistrimi i Pronës	76	74
Marrja e Kredisë	23	23
Mbrojtja e Investitorëve	100	176
Pagesa e Taksave	44	48
Tregtia përmes Kufijve	124	133
Zbatimi i Kontratave	138	139
Zgjidhja e Pamundësisë së Borxhit	87	86

Matjet e para të Bankës Botërore për Raportin e të Bërit Biznes (TBB) për Kosovë kanë filluar në vitin 2009. Sidoqoftë këto matje janë fokusuar vetëm në hapjen e biznesit të ri e jo edhe në indikatorët tjerë të këtij raporti. Nga viti 2010, Kosova është përfshirë në Raportin e të Bërit Biznes me matje në të gjitha kategoritë. Ky raport, i publikuar në fund të vitit 2010, e radhiti Kosovën në vendin 117 nga 183 shtete në botë. Këto matje të para për Kosovën janë shumë të

¹⁶ Shënime për të Dhënat, Raporti i të Bërit Biznes 2013, Banka Botërore. 2012.

¹⁷ Të Bërit Biznes në Evropën Jug Lindore 2011, Banka Botërore. Tetor 2010.

¹⁸ Profili Ekonomik: Kosova, Raporti i të Bërit Biznes 2013, Banka Botërore. Tetor 2012

rëndësishme për t'i përdorur si bazë për shënimin e përparimit në secilën nga kategoritë e raportit.

Në raportin e parë të të bërit biznes Kosova radhitet ndër të fundit nga vendet e rajonit. Në raportin e të bërit biznes për vitin 2011, më së miri nga vendet e rajonit u radhit Republika e Maqedonisë në vendin 38, e pasuar nga Mali i Zi në vendin 66, Shqipëria në vendin 82, Kroacia në vendin 84 dhe Serbia në vendin 89. Siç shihet, Maqedonia ka bërë përparime të dukshme në krahasim me vendet e rajonit duke u përkushtuar në reformat e të bërit biznes si formë e tërheqjes së investimeve të huaja direkte.

Kosova ka pësuar ndryshime në kategori individuale ndër vite edhe nëse nuk janë marrë masa për përmirësimin e treguesve. Ndryshimet në renditje na lënë të kuptojmë që edhe në rastet kur nuk ndryshon asgjë në procedurat, kohën dhe kapitalin që duhet investuar në një nga kategoritë, një shtet mund të pësojë rënie në renditje si rezultat i përmirësimit të shteteve tjera. Në anën tjetër kjo është e vërtetë edhe për përmirësimet nëpër kategori dhe rezultati i tyre në përmirësimin në renditje – pozita e një shteti në renditja nuk varet gjithmonë vetëm nga politikat dhe reformat e tij por edhe nga performanca e vendeve tjera.

2.2. NDIKIMI I RAPORTIT TË TË BËRIT BIZNES

Renditja e shtetit në raportin e TBB çdo ditë e më shumë po ndikon politik-bërjen e shteteve, posaçërisht atyre në zhvillim. Ekziston një keqinterpretim nga politikbërësit e shumë vendeve në zhvillim i cili dikton që nëse politikat publike fokusohen në përmirësimin e renditjes në raport, do ta përmirësojnë edhe mjedisin për zhvillim të biznesit dhe të sektorit privat në përgjithësi. Njëkohësisht këta politikbërës mendojnë se raporti shërben si udhëzues për investitorët potencial dhe sa më pozitiv të jetë ai aq më shumë ka gjasa për rritjen e investimeve të huaja. Sipas Grupit të Vlerësimit të Pavarur (IEG), 85% e politikbërësve e marrin parasysh radhitjen e shtetit të tyre në raportin e të bërit biznes si shtysë për reforma, mirëpo shumica e tyre nuk e cilësojnë si udhërrëfyes për të vepruar.¹⁹ Nga kjo shihet që ndikimi i raportit të të bërit biznes është shumë më i madh në politikbërësit e një vendi se sa në investitorët potencial.

Raporti i të bërit biznes ka një numër të madh të mangësive, të cilat tentojnë të përmirësojnë klimën e të bërit biznes, por nuk garantojnë zhvillim. Raporti ka ndikim më të madh në vendet në zhvillim, vende këto që pësojnë nga politikat që kanë prioritet përmirësimin e radhitjes në TBB mbi politikat që do të kishin rezultate në zhvillim ekonomik. Raporti i të bërit biznes lë anash një numër faktorësh që vendet në zhvillim mund t'i dëmtojnë në të ardhmen. Bazat e këtij raporti nuk inkurajojnë përfshirje më aktive të femrave në biznes e as nuk e promovojnë rëndësinë e një fuqie punëtore të kualifikuar. Në anën tjetër, raporti merr parasysh vetëm të dhënat për një kategori të caktuar të ndërmarrjeve që operojnë në kryeqytet duke i anashkaluar kështu bizneset e vogla dhe të mesme në vendet tjera, posaçërisht ato rurale. Kjo gjithashtu rezulton në mungesën e reformave të cilat do t'i ndihmonin ndërmarrjet e tilla që në vendet në zhvillim janë bartësit kryesor të ekonomisë vendore.

¹⁹ Raporti i të Bërit Biznes: Një Vlerësues i Pavarur, Banka Botërore dhe Grupi i Pavarur i Vlerësimeve. 2008

Përveç kësaj TBB në përgjithësi përkrah eliminimin e legjislacionit edhe nëse qëllimi i këtij legjislacioni është rregullimi i normave të cilat do të shiheshin si të favorshme për investitorët ose do të ndihmonin në ambientin ekonomik të një vendi. Norma të tilla janë ato mjedisore, të përfshirjes së pakicave si dhe ato të barazisë gjinore. Kjo vlen edhe për sistemin e taksimit. Në raportin e të bërit biznes, vlerësohet më lartë një sistem i cili ka taksa më të ulëta për korporatat, mirëpo në ekonomitë në zhvillim të ardhurat nga taksat janë të domosdoshme për funksionimin e aparatit shtetëror. Me ulje të taksave për korporatat, shteti duhet të mbajë në nivel më të lartë taksat në të ardhurat personale që ndikojnë në masë të madhe në mirëqenien sociale.

Në përgjithësi ndikimi i Raportit të të Bërit Biznes është shumë më i madh në politikat e një shteti se sa në perceptimin e investitorëve potencial. Ekziston një numër i madh i raporteve të tjera, përveç analizave të vetë investitorëve, të cilat investitorët i konsultojnë para se të marrin vendime rreth një shteti. Pa marrë parasysh raportet, vlerësimi përfundimtar i një investitori potencial bëhet në bazë të gjendjes reale në një shtet, gjendje e cila mund të rregullohet vetëm nëpërmjet vendimeve dhe veprimeve gjithëpërfshirëse të një shteti.

3. ANALIZË E VEPRIMEVE TË QEVERISË SË KOSOVËS

Gjatë vitit 2011, qeveria e Kosovës nuk ndërmori masa të dukshme për përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes. Kështu, në Raportin e të Bërit Biznes për vitin 2012, nuk pati ndryshime në radhitjen e përgjithshme. Mirëpo ndryshime ndodhën në radhitje të kategorive individuale si pasojë e përmirësimit të shteteve tjera. Në raportin e vitit 2012, Kosova pësoi rënie të mëtutjeshme në të gjitha kategoritë. Në kategorinë e hapjes së biznesit, që është kategoria më e lehtë për të reformuar, u radhit e 168-ta. Në kategorinë e marrjes së lejeve për ndërtim Kosova ra në vendin 171, në vendin 124 në sigurimin e energjisë elektrike, në vendin 73 në regjistrimin e pronës, në vendin 24 në marrjen e kredisë, në vendin 46 në pagesat e taksave dhe në vendin 131 në tregtinë përmes kufijve. Vendi nuk ndryshoi renditjen në kategorinë e zbatimit të kontratave dhe atë zgjidhjes së pamundësisë së borxhit. Në vitin 2012, Kosova vazhdoi të radhitet më së dobëti në kategorinë e mbrojtjes së investitorëve, duke rënë tutje nga vendi i 172 në vendin 174.

Në raportin e vitit 2012, në kategorinë e mbrojtjes së investitorëve, Kosova ishte 174-ta, e radhitur më mirë se vetëm tetë shtete të tjera të përfshira në raport të cilat janë Mikronezia, Gambia, Guineja, Gjibuti, Venezuela, Suriname, Laos dhe Afganistani.²⁰ Fatmirësisht, në raportin e fundit të TBB, kjo kategori ka shënuar rritjen më të madhe duke kaluar nga vendi i 174-të në vendin e 100-të.²¹ Megjithatë, mbetet të shihet sa ka ndikim përmirësimi i këtyre përmasave në investitorët e jashtëm dhe tërheqjen e investimeve.

Ky punim, ndër të tjera do të analizojë edhe ndërlidhjen e investimeve me kategorizimin e një shteti në raportin e të bërit biznes. Gjatë vitit 2012, Kosova është përkushtuar në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në mënyrë që kjo të rezultojë në përmirësimin e renditjes së Kosovës në TBB për vitin 2013. Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar një varg ligjesh që

²⁰ Raporti i të bërit biznes: të bërit biznes në një botë më transparente, Banka Botërore. Tetor 2011

²¹ Profili Ekonomik: Kosova, Raporti i të Bërit Biznes 2013, Banka Botërore. Tetor 2012.

në masë të madhe kanë përmirësuar krijimin e mjedisit afarist për NVM-të.²² Po ashtu në procedurën e miratimit janë Ligji për Mbrojtjen e Investimeve të Huaja, Ligji për Zonat Ekonomike, Ligji për Inspektoratin, si dhe Ligji për Leje dhe Licenca.²³ Të gjitha ligjet e adoptuara janë të parapara me Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014, ku shihet edhe themelimi i task forcës së të bërit biznes për të mbikëqyrur reformat në këtë fushë në të ardhmen.²⁴ Është më se e qartë që Qeveria e Kosovës po e përdor TBB si një njësi matëse për punën e tyre dhe synon ndërmarrjen e politikave që direkt i influencojnë treguesit në Raportin e të Bërit Biznes.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë gjithashtu ka zhvilluar Strategjinë e Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në të cilën i kushtohet rëndësi e madhe lehtësimit të procedurave që do të ndikojnë drejtpërdrejt në treguesit e TBB.²⁵ Qëllimi i parë dhe kryesor i kësaj strategjie është përforsimi i kornizës ligjore dhe rregullative. Në këtë strategji gjithashtu ka iniciativa për të lehtësuar hapjen e bizneseve, me regjistrimin e pronësisë, marrjen e kredive, si dhe lehtësimin e mbylljes e biznesit. Lehtësimi i të gjitha këtyre procedurave për NVM lidhet drejtpërdrejt me cilësimin e treguesve të Kosovës në indikatorët përkatës në raportin e TBB.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është institucioni që i ka kompetencat bazë për adresimin e ambientit të biznesit. Gjatë vitit të fundit, MTI i ka iniciuar pesë reforma duke u bazuar në tre indikatorë të Raportit e të Bërit Biznes. Eliminimi i lejes së punës, regjistrimi pa pagesë i biznesit, eliminimi ose reduktimi i kërkesës për kapital, reduktimi i dokumenteve për import/eksport dhe përmirësimi i mbrojtjes së investitorëve janë pesë reformat e ndërmarra nga MTI.²⁶ Këto reforma i shënojnë tre indikatorë të TBB të cilët janë fillimi i biznesit, tregtia përmes kufijve dhe mbrojtja e investitorëve. Rezultati i këtyre reformave pasqyrohet në progresin që ka shënuar Kosova në raportin e TBB të vitit 2013.

Sidoqoftë, duhet cekur që reformat legjislativë dhe lehtësimi i procedurave për hapje të biznesit janë të njohura si më të lehtë për tu ndërmarrë. Në vitin 2011, 53 ekonomi kanë realizuar reforma në këtë kategori duke përmirësuar procedurat e hapjes së biznesit²⁷, kurse për këtë vit, 41 shtete kanë bërë të njëjtën gjë.²⁸ Prandaj, ekziston një konkurrencë ndërmjet shteteve përmes reformave që synojnë vendosjen sa më të lartë në renditje, reforma të cilat shpesh financohen përmes programeve të Bankës Botërore në shtetet përkatëse.

Një praktikë tashmë e njohur e Bankës Botërore është financimi i projekteve që drejtpërdrejtë janë të lidhur me treguesin në raportin e tyre TBB. Banka Botërore përdorë këtë mundësi për të rritur numrin e reformave dhe njëkohësisht besueshmërinë e TBB. Ka raste kur implementimi i politikave që do të përmirësonin radhitjen në TBB është kusht për financim nga Banka

²² Këto përfshijnë: Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Tregtinë e Brendshme, Ligjin për Kadastër, Ligjin për Mbrojtjen nga Zjarri, Ligjin për Noterin, Ligjin për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim, Ligjin për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligjin për Aktivitetet e Tregtisë së Jashtme, Ligjin për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror.

²³ Ditët e Biznesit të Vogël 2012, Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, faqe 2.

²⁴ Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014, Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Korrik 2011

²⁵ Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016, Republika e Kosovës – Qeveria. Korrik 2012.

²⁶ Reformat e të bërit biznes, Republika e Kosovës - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

²⁷ Raporti i të bërit biznes: të bërit biznes në një botë më transparente, Banka Botërore. Tetor 2011

²⁸ Reformat biznesore për fillimin e biznesit, Të Bërit Biznes, Banka Botërore.

Botërore.²⁹ Ministria e Industrisë dhe Tregtisë ishte përfituese e një projekti nga Banka Botërore ku shtatë milionë dollarë janë dedikuar për përmirësimin e ambientit të biznesit. Projekti është aprovuar në qershor të vitit 2005 dhe ka përfunduar në maj të vitit 2012, ndërsa puna më e madhe ka ndodhur në 15 muajt e fundit të projektit.³⁰ Përfundimi i projektit në kohën kur edhe kanë përfunduar anketat dhe matjet për raportin TBB për vitin 2013 është i përshtatshëm për rezultatet e Kosovës për këtë vit. Sidoqoftë, mbetet të shihet nëse mungesa e një projekti të tillë gjatë vitit në vijim do të rezultojë në shtytje më pak agresive dhe përmirësim më të pakët të ambientit të të bërit biznes në Kosovë për vitin 2014.

3.1. PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIM TË TREGUESVE TBB

Angazhimi i madh i qeverisë së Kosovës në përmirësimin e treguesve në raportin e të Bërit Biznes shihet më së miri në Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014. I hartuar në pjesën e parë të vitit 2011, Plani gjithashtu i njohur edhe si Plani i Banskos, kishte për qëllim të krijojë një platformë të politikbërjes që ka për qëllim zhvillimin ekonomik të vendit. Ky plan i veprimit është përpiluar nga qeveria e Kosovës me qëllim të rritjes dhe zhvillimit ekonomik të vendit në një kohë të një krize politike kur Presidenti i vendit ishte zgjedhur me konsensus dhe kur ishte një presion për një plan kombëtar të zhvillimit. Ky plan gjithashtu u karakterizua me ndikim të konsiderueshëm të faktorëve ndërkombëtar. Plani i veprimit është i ndarë në pesë shtyllat në vijim: Ruajtja e Qëndrueshmërisë Makrofiskale; Investimet, Mjedisi Investues dhe Përkrahja e Sektorit Privat; Zhvillimi i Infrastrukturës Publike; Rivitalizimi i Sektorit të Bujqësisë; dhe Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor.³¹ Në këto kategori ka aktivitete që ndërlidhen drejtpërdrejt me treguesit e të bërit biznes dhe në Plan të Veprimit përmirësimi i këtyre treguesve paraqet indikatorë të suksesit në realizimin e aktiviteteve të parapara.

Në shtyllën e Ruajtjes së Qëndrueshmërisë Makrofiskale parashihen aktivitete në nënkategorinë e Krijimit të Mundësive për Qasje të Gjerë në Kapital. Kjo nënkategori parasheh pesë aktivitete në tërësi, nga të cilat dy kanë indikatorë të suksesit përmirësimin e treguesve të TBB në procedura të caktuara të dhjetë indikatorëve.

Shtylla e dytë e Planit të Veprimit të Qeverisë së Kosovës parasheh masat që duhen marrë për avancimin e Investimeve, Mjedisit Investues dhe Përkrahjen e Sektorit Privat. Kjo shtyllë parasheh gjithsej 48 aktivitete të ndara në shtatë nënkategori. Nga këto nënkategori, ajo e Përmirësimit të Ambientit të Biznesit nga 20 aktivitete të parapara suksesin e 15 prej tyre e matë me anë të përmirësimit të renditjes në raportin e TBB. Suksesi i përmirësimit të kësaj nënkategorie varet 75% nga raporti i Bankës Botërore që e matë mjedisin e të bërit biznes në vetëm dhjetë indikatorë.

Një nënkategori tjetër, që ka rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës, është ajo që parasheh hapat për lehtësimin e zhvillimit të tregtisë. Ky zhvillim parashihet të bëhet në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe në parimet e kërkesat e Bashkimit Evropian për të ulur koston dhe barrierat për tregti. Kosova çdo vit ballafaqohet me bilanc negativ tregtar dhe zhvillimi i një plani të veprimit për përmirësim në uljen e koston dhe

²⁹ Kosto Reale e Të Bërit Biznes, Global Labour University, Conor Cradden. Gusht 2011.

³⁰ Business Environment TA Project, Gjendja e Zbatimit dhe Rezultatet, Banka Botërore. Qershor 2012.

³¹ Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014, Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Korrik 2011

barrierave në tregti shihet si i mirëseardhur. Sidoqoftë, nga tetë aktivitete të parapara në këtë nënkategori, gjashtë kanë për qëllim përmirësimin e tregueseve në raportin TBB, ndërsa dy të mbeturat janë aktivitete për amendamentim të ligjeve.

Qeveria e Kosovës ka krijuar një ndërlidhje të drejtpërdrejt në mes të përmirësimit të indikatorëve në raportin e TBB dhe suksesit të zhvillimit ekonomik në vend në ato fusha ku raporti i TBB mund të përdoret si matës. Në anën tjetër, duke pasur parasysh që raporti i TBB nuk konsideron në matje infrastrukturën e një shteti, zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe në vitet e fundit as tregun e punës, një pjesë e madhe e aktiviteteve të përfshira në këto tri shtyllat e fundit të Planit të Veprimit të Qeverisë nuk kanë indikatorë të suksesit fare.

Përdorimi i një raporti të tillë të kufizuar si masë për arritjen e objektivave të zhvillimit ekonomik dhe si shtysë për reforma e bën vizionin e politikave ekonomike të një vendi të jetë i kufizuar. Një ekonomi në zhvillim si Kosova ka nevojë për politika zhvillimore të cilat fillimisht janë të fokusuara në përmirësimin e gjendjes së ekonomisë vendore duke promovuar bizneset e vogla dhe të mesme vendore, e jo për politika të cilat i japin prioritet përmirësimit të treguesve në një raport si ai TBB. Fokusi i ngushtë në një raport të tillë po ashtu ngritë barriera në përpilimin dhe implementimin e politikave inovative e kreative.

4. NDIKIMI I TBB NË INVESTIME – PRAKTIKA NGA VENDET TJERA

Një ndër forcat shtytëse për përmirësimin e renditjes në Raportin e të Bërit Biznes është tërheqja e investimeve të huaja direkte. Në ekonominë në zhvillim, si Kosova, investimet e huaja direkte janë tejet të rëndësishme për përparimin e ekonomisë dhe stabilizimin e saj. Qeveria e Kosovës, posaçërisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka punuar në drejtim të përmirësimit të renditjes së Kosovës në këtë raport. Megjithatë, si është treguar më lartë, përmirësimi i renditjes nuk do të thotë që do të ketë rritje të IHD. Në vitet e fundit të treguesve të TBB, në Europën Lindore ka pasur dy shtete që janë përkushtuar në masë më të madhe në reforma për përmirësimin e renditjes, Maqedonia dhe Gjeorgjia. Të dy këto shtete kanë qenë ndër reformuesit kryesor dhe kanë arritur që brenda një kohe të shkurtër të përmirësojnë renditjen e tyre në këtë raport. Sot, Gjeorgjia qëndron në vendin e nëntë, ndërsa Maqedonia në vendin 23-të. Sidoqoftë, investimet e huaja direkte jo vetëm që nuk janë rritur proporcionalisht me përmirësimin e renditjes në raportin e të bërit biznes, por ka pasur raste kur ato edhe kanë pësuar rënie.

4.1. GJEORGJIA

Rasti i cili përdoret nga shkollarët anë e kënd botës për të treguar se si përmirësimi në TBB nuk ndikon në investimet e huaja, e për më tepër, ndikon negativisht në promulgimin e politikave të mirëfillta zhvillimore, është shteti kaukazian i Gjeorgjisë. Në vitin 2006 kur Gjeorgjia radhitej në vendin 112 në raportin e të bërit biznes, totali i IHD në Gjeorgji ishte USD 1,170,077,393.25. Gjatë këtij viti në publikimin e raportit, Gjeorgjia bën një hap të madh në TBB duke u radhitur në vendin 37, që është 203% renditje më e favorshme se në vitin paraprak. Investimet e huaja direkte, sidoqoftë, për këtë vit rriten në USD 1,564,030,345.11 që është afërsisht vetëm 50% më

shumë se në vitin paraprak. Ani pse Gjeorgjia vazhdon të përmirësohet në renditjen e saj në TBB, IHD-të nuk përcjellin trendin e njëjtë.

GJEORGJIA

TBB ³²				IHD (USD) ³³			
2006	112			2006	1,170,077,393.26		
2007	37	3.03	203%	2007	1,750,242,587.70	1.50	50%
2008	18	2.06	106%	2008	1,564,030,345.11	0.89	-11%
2009	15	1.20	20%	2009	658,400,605.82	0.42	-58%
2010	11	1.36	36%	2010	816,708,508.75	1.24	24%
2011	12	0.92	-8%	2011	973,108,274.92	1.19	19%
2012	16	0.75	-25%	2012			

Siç shihet në tabelën e mësipërme nuk ka korrelacion të drejt në mes të ngritjes në renditje të një shteti në TBB edhe rritjes së IHD. Kjo është edhe më e evidente në rastin e Maqedonisë.

4.2. MAQEDONIA

Ndër vendet e rajonit, Maqedonia vazhdon të kryesojë në TBB si rezultat i një varg reformash të ndërmarrë nga viti 2006 e tutje. Në raportin e vitit 2012, Maqedonia është renditur në vendin 22 nga 183 shtete.

MAQEDONIA

TBB ³⁴				IHD (USD) ³⁵			
2006	94			2006	424,155,269.27		
2007	92	1.02	2%	2007	699,092,642.00	1.65	65%
2008	75	1.23	23%	2008	586,953,718.61	0.84	-16%
2009	71	1.06	6%	2009	197,089,613.49	0.34	-66%
2010	32	2.22	122%	2010	207,463,067.12	1.05	5%
2011	38	0.84	-16%	2011	409,958,903.23	1.98	98%
2012	22	1.73	73%	2012			

Për dallim nga Gjeorgjia, tek e cila shohim rritje sado të vogël të IHD në përputhshmëri me përmirësimin e renditjes në TBB, tek Maqedonia nuk shohim diçka të tillë. Fillimisht duhet cekur që investimet e huaja direkte në Maqedoni janë konsiderueshëm më të vogla se në vendet tjera të rajonit, duke përfshirë këtu deri në një masë edhe Kosovën.

Reformat e të bërit biznes në Maqedoni ndikuan që nga vendi 92 në vitin 2007 ky shtet të renditet në vendin 75 në vitin 2008, një përmirësim prej 23%. Mirëpo një përmirësim i tillë në renditje në TBB nuk rezultoi në rritje investimeve, por në ulje të tyre për 16% nga viti paraprak. Investimet e huaja direkte pësuan rritje të mëtutjeshme për 65% në vitin 2009, gjë që mund t'i

³² Raporti i të bërit biznes: të bërit biznes në një botë më transparente, Banka Botërore. Tetor 2011

³³ Investimet e Huaja Direkte, Banka Botërore. 2012

³⁴ Raporti i të bërit biznes: të bërit biznes në një botë më transparente, Banka Botërore. Tetor 2011

³⁵ Investimet e Huaja Direkte, Banka Botërore. 2012

atribuohet krizës financiare botërore. Mirëpo, Maqedonia, për dallim nga vendet tjera, pësoi edhe rënie më të madhe të investimeve në vitin 2009 si dhe ngritje më të vogël në vitin 2010, në krahasim me vendet e rajonit. Në vitin 2011 Maqedonia pësoi rënie në renditje të TBB nga 32 në 38, ndërsa investimet e huaja direkte në këtë vend u ngritën për 98%.

Përveç statistikave të mësipërme që tregojnë se renditja pozitive në TBB nuk garanton tërheqje të investimeve, një krahasim i investimeve të huaja direkte në Kosovë dhe në Maqedoni, duke i pasur parasysh edhe renditjen e këtyre dy shteteve në TBB, mund të na japë një pamje më të qartë.

KOSOVA					
TBB³⁶			IHD (USD)³⁷		
2006	N/A		2006	369,808,407.38	
2007	N/A		2007	603,224,093.07	1.63118 63%
2008	N/A		2008	536,790,831.64	0.88987 -11%
2009	107*		2009	408,068,782.77	0.760201 -24%
2010	113*	0.946903 -5%	2010	457,269,392.08	1.120569 12%
2011	117	0.965812 -3%	2011	546,217,228.95	1.19452 19%
2012	117	1 0%	2012		

*Në raportet e të Bërit Biznes të vitit 2010 dhe 2011 renditja e Kosovës në vitin paraparak përfshihet në tabelë të vitit 2010 respektivisht të vitit 2011 dhe shërben si krahasim.

Nëse i krahasojmë IHD me renditjen në TBB në mes të Kosovës dhe Maqedonisë shohim që, duke e anashkuar vitin 2009, në vitin 2010 Kosova kishte 220% të IHD të totalit të Maqedonisë, duke qenë në vendin 113 për dallim prej Maqedonisë në vendin 32. Në vitin 2011, Kosova u ndodh në vendin 117, Maqedonia në vendin 38, ndërsa Kosova këtë vit morri 133% të investimeve totale që i morri Maqedonia.

Kështu shihet që edhe nëse ka përmirësime në renditjen e një vendi në raportin e të bërit biznes, korrelacioni i investimeve të huaja direkte me këtë renditje nuk është aq i lartë. Kjo na lë të kuptojmë që edhe po t'i lëmë anash të gjitha mangësitë e raportit, përfshirë këtu edhe mungesën e adresimit të shumë faktorëve të rëndësishëm ekonomik, ky raport nuk mund të përdoret si forcë kryesore nxitëse për politik-bërje në një shtet.

5. INDIKATORËT TJERË PËR TË KONSIDERUAR

Hartimi i planeve të zhvillimit ekonomik nga qeveria duhet të përfshijë një spektër të gjërë të indikatorëve të cilët mbulojnë pjesën më të madhe të sektorëve në një shtet. Një platformë e tillë e politikave publike që adreson numër më të madh të çështjeve garanton stimulimin e zhvillimit ekonomik. Në anën tjetër, investitorët potencial bazojnë vendimet e tyre në indikatorë dhe analiza sa më gjithëpërfshirëse. Fokusi i politikbërjes në një raport të vetëm ndikon negativisht jo vetëm në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm por edhe në tërheqjen e investimeve të huaja. Raportet ekonomike në vazhdim përfshijnë një tërësi treguesish ekonomik që ndikojnë si në

³⁶ Raporti i të bërit biznes: të bërit biznes në një botë më transparente, Banka Botërore. Tetor 2011

³⁷ Investimet e Huaja Direkte, Banka Botërore. 2012

perceptimin e investitorëve potencial ashtu edhe në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të një vendi.

5.1. INDEKSI I PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT³⁸

Transparency International publikon çdo vit indeksin e perceptimit të korrupsionit për 183 shtete në botë, përfshirë këtu edhe Kosovën. Ky indeks e matë perceptimin për nivelin e korrupsionit të sektorit publik në një shtet dhe i radhitë shtetet bazuar në indeksin prej 0 deri në 10, ku 0 do të thotë që një shtet perceptohet të ketë nivel shumë të lartë të korrupsionit ndërsa 10 do të thotë që shteti perceptohet të mos ketë korrupsion. Rënditja e një shteti në këtë listë tregon pozicionin e atij shteti në krahasim me shtetet tjera të përfshira në këtë listë. Në këtë raport, Kosova gjendet në vendin 112, me indeks prej 2.9. Kosova radhitet si shteti me perceptimin më të lartë të korrupsionit në rajon. Mali i Zi ka indeksin më pozitiv, prej 4.0 dhe radhitet në vendin 66. Atë e pasojnë Maqedonia me indeks 3.9 në vendin 69, Serbia me indeks 3.3 në vendin 86, Bosnja dhe Hercegovina me indeks 3.2 në vendin 91 dhe Shqipëria me indeks 3.1 në vendin 95. Kosova në raportin e perceptimit të korrupsionit ndodhet në pjesën e poshtme të renditjes duke mbetur në 40%shin të fundit të shteteve.

Që mospërfshirja e nivelit të korrupsionit në Raportin e të Bërit Biznes është një ndër mangësitë kryesore më së miri kuptohet në rastin shtetit të Afganistanit. Ky shtet ndër vite radhitet jashtëzakonisht mirë në treguesin e fillimit të biznesit duke qenë në vendin e 29 dhe 28 për vitet 2013 dhe 2012 respektivisht.³⁹ Megjithatë, komuniteti i biznesit në Afganistan thotë se këto të gjetura të TBB janë të vërteta vetëm për ata që japin të holla zyrtarëve që merren me regjistrim.⁴⁰ Kjo shihet edhe në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit në të cilin Afganistani është ndër shtetet më së dobëti të renditura. Ky shtet qëndron në vendin 180, me indeks 1.5, duke i lënë pas vetëm dy vende tjera. Kësisoj, një renditje e favorshme në TBB nuk është garanton shumë dhe reformat që kanë për bazë TBB nuk janë të mjaftueshme për të ndërruar gjendjen në praktikë.

Për investitorët potencial, indeksi i lartë i perceptimit të korrupsionit paraqet jo vetëm nivel të lartë të mosbesimit të shoqërisë në organet udhëheqëse të shtetit, por gjithashtu edhe rrezik për vështirësi shtesë në operimin e biznesit

5.2. RAPORTI GLOBAL I KONKURENCËS⁴¹

Ky raport publikohet nga Forumi Ekonomik Botëror (FEB) dhe matë nivelin e konkurrencës në një vend bazuar në 12 shtyllat në vijim: Institucionet, Infrastruktura, Mjedisi Makroekonomik, Shëndeti dhe Arsimi Fillor, Arsimi i Lartë dhe Trajnimi, Eficienca e Tregut të Mallrave, Eficienca e Tregut të Punës, Zhvillimi i Tregut Financiar, Gatishmëria Teknologjike, Madhësia e Tregut, Sofistikimi i Biznesit, dhe Risitë Teknologjike. Këto 12 shtylla ndahen në tri kategori, katër shtyllat e para plotësojnë kategorinë e parë të kërkesave themelore që janë kyçe për ekonomitë e nxitura nga faktorët. Shtyllat 5-10 i përkasin kategorisë së dytë të rritjes së efikasitetit dhe janë karakteristike për ekonomitë e nxitura nga efikasiteti ndërsa dy shtyllat e fundit i përkasin

³⁸ Indeksi i perceptimit të korrupsionit, Transparency International. 2011

³⁹ Profili Ekonomik: Afganistani, Raporti i të Bërit Biznes 2013, Banka Botërore. Tetor 2012.

⁴⁰ Përdorimet dhe Shpërdorimet e Treguesve të Raportit të Bërit Biznes, USAID, Wade Channel. Maj 2008.

⁴¹ Raporti Global i Konkurrencës, Klaus Schwab, Forumi Ekonomik Botëror. 2012

kategorisë së fundit të faktorëve të rrisë dhe sofistikimit që janë bazë për ekonomitë e nxitura nga rrisë.

Ky raport nuk e përfshinë Kosovën në llogaritje. Sidoqoftë, vendet e rajonit ndodhen të gjitha në fazën e dytë, atë të ekonomive të nxitura nga efikasiteti. Bazuar në gjendjen ekonomike të vendit tonë, përfshirja në këtë raport edhe më tutje do të vinte në pah sa prapa vendeve të rajonit ngelë Kosova. Me një skenar optimist, Kosova do të bënte pjesë në fazën e tranzicionit nga faza 1 e ekonomive të nxitura nga faktorët për në fazën 2 të ekonomive të nxitura nga efikasiteti. Në anën tjetër, një skenar më realist e vë Kosovën në fazën e parë të ekonomive të nxitura nga faktorët. Nga vendet e rajonit, Mali i Zi është i radhituri më së larti, në vendin 72, i pasuar nga Maqedonia në vendin 80, Bosnja dhe Hercegovina në vendin 88, Shqipëria në vendin 89, dhe Serbia në vendin 95.

Renditja në një raport të tillë do të kishte ndikim më të madh tek investitorët potencial, duke pasur parasysh së ky raport përfshinë një numër më të madh të faktorëve në metodologjinë për përcaktimin e nivelit të konkurrencës të një shteti.

5.3. INDEKSI I LIRISË EKONOMIKE⁴²

I publikuar nga Heritage Foundation dhe the Wall Street Journal, ky indeks analizon dhjetë komponentë specifik të lirisë ekonomike të grupuara në katër kategori. Kategoritë janë Sundimi i Ligjit (që përfshinë të drejtat pronësore dhe lirinë nga korrupsioni); Qeverisja e Kufizuar (liria fiskale dhe shpenzimet e qeverisë); Efikasiteti i Rregullatorit (liria e biznesit, liria e tregut të punës, liria monetare); dhe Tregu i Hapur (liria e tregtisë, liria e investimeve, liria financiare).

Ky raport gjithashtu nuk e përfshinë Kosovën në renditje, mirëpo, në dukje Kosova nuk do të ndodhej shumë më mirë se vendet e rajonit në radhitje. Në këtë raport, nga vendet e rajonit, Maqedonia zë vendin 45, Shqipëria vendin 57, Mali i Zi vendin 72, Serbia zë vendin 98, dhe Bosnja dhe Hercegovina zë vendin 104. Shqipëria dhe Serbia nga të gjitha kategoritë, indeksin më të ulët e kanë në komponentin e lirisë nga korrupsioni. Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë indeksin më të ulët në të drejtat pronësore, ndërsa Mali i Zi ka indeksin më të ulët në shpenzimet qeveritare. Këto tri komponentë paraqesin edhe komponentët më problematikë në përgjithësi për rajonin.

Duke i pasur parasysh këtë numër të madh të komponentëve të analizuara në raporte të ndryshme botërore që mund të ndikojnë vendimmarrjen e investitorëve potencial, shihet që fokusi i tepruar në përmirësimin e radhitjes në raportin e bankës botërore të të bërit biznes është problematik. Kosova ka vend për reforma në shumë fusha tjera, jashtë atyre të përfshira në Raportin e të Bërit Biznes të cilat mund të ndikojnë më shumë në tërheqjen e investimeve të huaja.

Ulja e korrupsionit, përmirësimi i infrastrukturës, investimi në arsimim dhe trajnim të kuadrove, zhvillimi i një mjedisi makroekonomik, duke përfshirë edhe përmirësimin e tregtisë jashtë kufijve, do të ndikonin në masë të madhe në përceptimin e Kosovës nga investitorët e huaj. Sidoqoftë,

⁴² Indeksi i Lirisë Ekonomike 2012, The Herritage Foundation, The Wall Street Journal. 2012

fokusi në këta komponentë gjithashtu do të ndikonte pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit me prodhimtarinë vendore si shtyllë.

5.4. INDEKSI I TRANSFORMIMIT I FONDACIONIT BERTELSMANN⁴³

Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann (BTI) analizon dhe vlerëson nëse vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion drejtojnë ndryshimet shoqërore drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut dhe si e bëjnë këtë. BTI është i bazuar në dy indekse, atë të statusit dhe atë të menaxhimit. Indeksi i Statusit në dy dimensione analitike vlerëson transformimin politik drejt demokracisë nën sundimin e ligjit dhe transformimin ekonomik drejt ekonomisë së tregut nën principet e drejtësisë shoqërore. Indeksi i Menaxhimit vlerëson kualitetin e qeverisjes dhe ndikimin e vendimmarrjes në drejtimin e proceseve politike.

Nga gjithsej 128 shtete të përfshira në këtë indeks, Kosova radhitet në vendin 41 në Indeksin e Statusit dhe cilësohet si shtet *i limituar*. Në transformimin politik Kosova radhitet në vendin 43 dhe cilësohet si demokraci e mangët, ndërsa në transformimin ekonomik radhitet në vendin 58 dhe cilësohet si ekonomi me mangësi funksionale. Në Indeksin e Statusit, vendet e rajonit hyjnë në radhët e shteteve të avancuara. Kroacia radhitet e 15-ta, Serbia e 21-ta, Maqedonia e 25-ta, Mali i Zi i 27-ti dhe Shqipëria e 31-ta. Ndërsa Bosnja e Hercegovina radhitet e 39 po ashtu e cilësuar si shtet i limituar.

Në Indeksin e Menaxhimit, Kosova dhe Shqipëria cilësohen si shtete me kualitet të moderuar të menaxhimit të qeverisjes, të radhitura në vendin 57 respektivisht 52. Bosnja dhe Hercegovina radhitet më së dobëti në rajon, në vendin 95, e cilësuar si shtet me qeverisje me menaxhim të dobët. Serbia, Mali i Zi, Kroacia dhe Maqedonia cilësohen si shtete me kualitet të mirë të menaxhimit të qeverisjes.

5.5. PERCEPTIMI I KOSOVËS DHE SFERA NDËRKOMBËTARE

Perceptimi i Kosovës nga ana e investitorëve potencial varet nga opinioni publik ndërkombëtar për Kosovën. Vendi ynë cilësohet si vend në tranzicion dhe jo stabil si politikisht ashtu edhe ekonomikisht. Kjo reflekton edhe në bindjet se korrupsioni është një ndër problemet më të mëdha me të cilat duhet ballafaquar për të drejtuar një biznes. Në një raport të vitit 2008 të publikuar nga Oda Ekonomike Amerikane, 47% të bizneseve citohen të besojnë se zhvillimi efektiv i biznesit në Kosovë varet nga dhënia e ryshfetit institucioneve të Kosovës. Në anën tjetër, 12% e bizneseve e cilësojnë këtë si të vërtetë vetëm për institucione të caktuara.⁴⁴

Për më tepër, mungesa e transparencës në institucione të Kosovës dhe mungesa e stabilitetit politik ndikon në perceptimin e Kosovës si vend me politika zhvillimore jo të mjaftueshme dhe mjedis ekonomik të paqëndrueshëm. Politikbërja në Kosovë ka nevojë për fokus të gjerë që i adreson të gjitha çështjet problematike me të cilat ballafaqohet vendi ynë.

⁴³ Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann, Bertelsmann Stiftung. 2012

⁴⁴ Ndikimi i Korrupsionit në Komunitetin e Biznesit në Kosovë, Kushtrim Shaipi, American Chamber of Commerce. 2008

6. PËRFUNDIME

Raporti i të Bërit Biznes është një instrument i dobishëm që ofron statistika rreth cilësisë së ambientit të të bërit biznes për 185 vende të ndryshme botës. Sidoqoftë, vetë Banka Botërore, hartuesi i këtij raporti, i pranon publikisht një mori kufizimesh siç është fokusi vetëm në qytetin më të madh, vetëm në ekonominë formale dhe vetëm ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Për më tepër, Banka Botërore thekson që fokusi i drejtpërdrejt vetëm në përmirësimin e renditjes në TBB nuk do të garantojë përmirësim të mjedisit të të bërit biznes. Si rezultat, siç sugjerojnë edhe përvojat e vendeve të tjera, ndryshimet në praktikë kërkojnë politika përtej raportit TBB dhe investitorët nuk e konsiderojnë raportin si instrument për vendimmarrje.

Institucionet të Kosovës e kanë përdorur raportin e TBB si mjet bazë për përpilimin e politikave lidhur me të bërit biznes e mbase edhe të gjithë zhvillimit të sektorit privat. Themelet e këtyre politika janë draftuar në Planin e Banskos, apo siç quhet zyrtarisht Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014, ku specifikisht thuhet që përmirësimi në TBB është objektivë e 23 aktivitete dhe krijimi i task forcës së të bërit biznes. Si rezultat, Qeveria e Kosovës i ka miratuar një seri ligjesh për përmirësimin e mjedisit afarist për NVM-të. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, duke u bazuar në një raport që assesi nuk garanton përmirësime reale të gjendjes, i ka zbatuar pesë reforma për të rritur rezultatin në tre tregues të raportit TBB.

Raporti i Bankës Botërore për lehtësinë e të bërit biznes fokusohet në masë të madhe në rregulloret dhe kornizat legjislative që rregullojnë secilin nga indikatorët e matur në këtë raport. Kosova deri më tani ka shfaqur gatishmëri të madhe për amandamentimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për t'i harmonizuar ato me direktivat Europiane dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. Sidoqoftë, problemi madhor i Kosovës nuk është mungesa e ligjeve të përditësuara me legjislacionin ndërkombëtar por zbatimi i tyre në praktikë. Si rezultat, përmirësimi i Kosovës në renditjen e raportit të të bërit biznes është drejtpërdrejt i ndërlidhur me përmbajtjen e ligjeve dhe atë se çka ato tentojnë të rregullojnë, e jo me zbatimin e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi i renditjes në raportin TBB nuk paraqet pasqyrë të qartë të zhvillimeve reale në vend.

Vendeve në zhvillim, si Kosova, iu ndodhë edhe më keq kur politikbërësit limitohen tërësisht në reforma selektive sa për të përmirësuar pozitën në TBB, duke shkaktuar kështu stagnime të qëndrueshme të zhvillimit të sektorit privat. Kjo kryesisht për shkak se i gjithë potenciali politik e administrativ është përqendruar në përmirësimin e TBB-së, duke lënë anash të gjitha fushat tjera të rëndësishme. Pas kësaj analize, mund të përfundojmë se ky limitim ka qenë i gabuar dhe veç sa ka ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit. Për më shumë, përkundër gjithë angazhimeve ekskluzive për të përmirësuar pozitën në TBB, institucionet e Kosovës nuk e kanë arritur një gjë të tillë, meqë përmirësimi është vetëm për 19 vende.

Kosova mund të jetë në top reformuesit e raportit e edhe në top 40 apo 20 vendet në renditje të TBB edhe nëse gjithë reforma politike e administrative e së ardhmes shkon në këtë drejtim. As atëherë krizën ekonomike në rritje e sipër nuk do ta mund ta zhdukim përmes investimeve të huaja direkte, meqë siç tregojnë praktikatat e vendeve tjera, renditja e mirë në TBB nuk garanton rritjen e nivelit të investimeve të huaja në atë shtet. Kjo shihet nga praktikatat e vendeve si Maqedonia e Gjeorgjia, suksesi i të cilave në renditjen në raportin e të bërit biznes nuk ka

rezultuar në rritjen e investimeve. Duke pasur parasysh që një ndër qëllimet më të rëndësishme të një ekonomie në zhvillim, si kjo e jona, është tërheqja e investimeve të huaja direkte, përqendrimi i përmasave të mëdha në përmirësimin e renditjes së shtetit në raportin e TBB paraqet fokusim jo eficient të politikave zhvillimore.

Si një vend që ka nevojë për një zhvillim të hovshëm, të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik, Kosova nuk mund të presë të mësoj prej gabimeve të saj, siç ka bërë sivjet me raportin e TBB. Gabimet e vendeve tjera, sidomos vendeve me një situatë të ngjashme politike, sociale e mbi të gjithash ekonomike, duhet të shërbejnë si mësim sistematik në krijimin e politikave publike. Limitimi i tyre në indikatorë të përzgjedhur të suksesit mund të tingëllojnë mirë në letër, por nuk e përmirësojnë mjedisin e biznesit në Kosovë.

ISBN 978-9951-627-08-5



9 789951 627085

INDEP 2012